

Vendim nr. 175, datë 29.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahim, Anëtar

në datën 29.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ANTERIO KALOSHI, përfaqësuar nga avokati Detar Hysi, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 4, datë 25.01.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 15, datë 20.03.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00 – 2025 – 1775 (278), datë 20.11.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 30, 31, 32, 34, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6, paragrafët 1 dhe 3, 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 4 i Protokollit nr. 7 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të

Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (*Prokuroria e Posaçme*) për kryerjen e disa veprave penale të lidhura me ngjarjen e datës 11.10.2017 në qytetin e Lushnjës, gjatë së cilës janë vrarë dy shtetas dhe janë plagosur dy të tjerë. Gjithashtu, nga rrethanat rezulton se këtij sulmi i ka shpëtuar shtetasi Xhulio Shkurti, i cili sapo ishte larguar nga vendngjarja. Sipas hetimit, kërkuesi së bashku me dy shtetas të tjerë u janë afruar viktimave me një automjet dhe pasi kanë zbritur prej tij kanë qëlluar në drejtim të tyre me armë zjarri.

2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 4, datë 25.01.2022, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” ndaj dy ose më shumë personave, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, “Grupi i strukturuar kriminal” në formën e pjesëmarrjes, të parashikuara nga nenet 79/dh, 28, pika 4, 278, paragrafi i parë, 333/a, paragrafi i dytë, dhe 334, pika 1, të Kodit Penal (*KP*), si dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Kjo gjykatë ka vendosur pushimin e akuzës penale për veprën penale “Vrasja me paramendim”, të mbetur në tentativë, në dëm të viktimës Xh.Sh., të kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 78, paragrafi i dytë, e 22, në lidhje me nenin 28, pika 4, të *KP*-së, si dhe për veprën penale “Prishja e qetësisë publike”, të kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 274 dhe 28, pika 4, të *KP*-së,

pasi ndjekja penale nuk duhet të fillonte. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesi dhe Prokuroria e Posaçme.

3. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 15, datë 20.03.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e deklaruar kërkuesin fajtor edhe për veprën penale “Vrasja me paramendim” për hakmarrje e mbetur në tentativë ndaj viktimës Xh.Sh. të parashikuar nga neni 78, paragrafi i dytë, në lidhje me nenet 22 dhe 28, pika 4, si dhe 334, pika 1, të KP-së, duke e dënuar me 25 vjet burgim dhe, në bashkim të dënimeve, caktimin e një dënimi të vetëm me burgim të përjetshëm. Po kështu, kjo gjykatë ka ndryshuar vendimin për deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, duke konsideruar se neni 334 i KP-së parashikon sanksion shtesë dhe jo vepër penale më vete. Nga ana tjetër, GJKKO-ja e Apelit ka lënë në fuqi vendimin për pjesët e tjera.

4. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025 - 1775 (278), datë 20.11.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se pretendimet e ngritura në interpretim të shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) nuk janë të tilla që cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit. Ky kolegji ka shqyrtuar edhe në themel këto pretendime, duke arritur në përfundimin se janë haptazi të pabazuara.

5. Në datën 10.03.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

6.1. *Të drejtën për proces të rregullt* në drejtim të:

6.1.1. *Parimit të paanshmërisë*, pasi gjyqtaret M.M. dhe I.O. kanë qenë anëtare të trupit gjykues në seancat gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë gjatë të cilave janë marrë provat kryesore dhe kanë dhënë vendime të ndërmjetme për kërkesat e

mbrojtjes duke i rrëzuar ato. Këto gjyqtare kanë shqyrtuar të njëjtat prova dhe fakte në cilësinë e anëtareve të trupit gjykues në gjykatën e apelit. Në këtë mënyrë këto gjyqtare kishin formuar bindjen se ato prova ishin të panevojshme. Gjykata e Lartë ka bërë një interpretim formalist për këtë pretendim të kërkuarit, pasi këto gjyqtare kanë dhënë vendime për rrëzimin e kërkesave për ekspertimin mbi pamjet filmike, qelizat telefonike, marrjen e dëshmitarëve kyç të mbrojtjes.

6.1.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi gjykatat refuzuan ekspertimin mbi pamjet filmike dhe fotografike, ndonëse kërkuar ka pasur pretendime për autenticitetin e materialit dhe origjinalitetin e burimeve. Megjithatë mbrojtja ka depozituar një akt ekspertimi kriminalistik, i cili konkludonte se identifikimi i kërkuarit nëpërmjet materialit fotografik filmik ishte i pasigurt, GJKKO-ja e Apelit ka rrëzuar kërkesën për riçelje të shqyrtimit gjyqësor, me qëllim kryerjen e ekspertimit zyrtar. Një tjetër provë e refuzuar nga gjykata ishte edhe analiza e qelizave telefonike e cila është kryer nga oficerë policie dhe jo nga ekspertë të fushës së telekomunikacioneve. Gjithashtu, gjykatat kanë refuzuar edhe thirrjen e dëshmitarëve kyç të mbrojtjes dhe ballafaqimin e dy prej tyre.

6.1.3. *Së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, të garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës, pasi procesi i marrjes së materialeve fotografike/filmike nga shtetasi F.L. paraqet shkelje në këto drejtime: (i) fotografitë e marra sipas procesverbalit përbëjnë në fakt një akt të mirëfilltë njohjeje personash nëpërmjet fotografive, institut i rregulluar nga nenet 171-175 të KPP-së, ndërsa prokuroria e ka formalizuar këtë akt si marrje dokumentesh sipas nenit 191 të KPP-së, duke shmangur garancitë procedurale të njohjes; (ii) shtetasi F.L. ka deklaruar se i kishte siguruar fotografitë “në mënyrë private” dhe nuk ka treguar burimin, në ndalim të nenit 194 të KPP-së; (iii) çdo fotografi ishte shoqëruar me etiketime dhe komente private të personave, çka dëshmon ndërhyrje materiale mbi integritetin e provës; (iv) për origjinalitetin e materialeve audiovizive kërkohet zinxhir i dokumentuar

ruajtjeje, i cili nuk është bërë në rastin konkret. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka lejuar kryerjen e procedurës *de facto* të njohjes nëpërmjet fotografive brenda seancave të marrjes me dëshmi duke shkrirë dy institute juridike të ndryshme (neni 361 i KPP-së, marrja e dëshmisë, dhe nenet 171-175 të KPP-së, njohja e personit). Në këtë mënyrë gjykatat kanë shkelur formën e parashikuar shprehimisht nga neni 172 i KPP-së, kanë privuar garancitë e neneve 171, pika 1, dhe 172, pika 1, si dhe kanë cenuar nenin 361, pika 3, të KPP-së për ndalimin e pyetjeve sugjestuese. Gjithashtu, aktet për zgjatjen e hetimeve paraprake kanë qenë të pavlefshme, pasi ato nuk iu njoftuan të pandehurit dhe mbrojtësit të tij dhe disa mbajnë nënshkrimin e mbrojtësit kryesisht, i cili nuk ishte caktuar me vendim të dokumentuar.

6.1.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi gjykatat nuk dhanë asnjë shpjegim se përse deklaratimet fillestare të dëshmitarëve okularë janë anashkaluar ose përse janë pranuar deklaratimet e dyta. Edhe Gjykata e Lartë e ka pranuar këtë arsyetim pa dhënë asnjë shpjegim.

6.2. *Parimin e mosdënimit pa ligj*, pasi gjykatat kanë rrëzuar kërkesën për gjykim të shkurtuar me arsyetimin se neni 403, pika 2, i KPP-së ndalon gjykimin e shkurtuar për veprat penale që dënohen me burgim të përjetshëm. Kjo dispozitë krijon diskriminim ndaj personave të akuzuar për vepra që dënohen me burgim të përjetshëm të cilët privohen nga mundësia e uljes së dënimit prej gjykimit të shkurtuar, pavarësisht pranimit të akuzës. Ky trajtim i diferencuar nuk ka justifikim proporcional sipas nenit 18 të Kushtetutës.

6.3. *Parimin ne bis in idem*, pasi kërkuesi është dënuar njëkohësisht për veprat penale konkrete (nenet 78, pika 2, 79/dh, 278 të KP-së), “Grupi i strukturuar kriminal” (neni 333/a, pika 2, i KP-së) dhe “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal” (neni 334, pika 1, i KP-së). Pra, gjykatat kanë aplikuar në mënyrë kumulative dy dispozita ndaj të njëjtit fakt, bashkëpunimit kriminal.

6.4. *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, pasi megjithëse GJKKO-ja e Apelit ka pranuar faktin se provat nuk e vendosin kërkuesin qartë në vendin e ngjarjes, ajo ka caktuar

fajësinë e tij si “anëtar kontribues i grupit kriminal”, konkluzion i cili është marrë pa u proceduar me riçelje të shqyrtimit gjyqësor dhe pa rimarrë provat, duke u mbështetur vetëm mbi analizën e fakteve gjatë procesit të gjykatës së shkallës së parë. Kjo qasje dhe konstatimi i fajësisë mbi prova indirekte, pa lidhje të drejtpërdrejtë me vendin e ngjarjes, pa dëgjuar drejtpërdrejt provat, cenon standardin tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

6.5. *Parimin e ligjshmërisë*, pasi GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për sa i përket fajësisë së kërkuesit, duke e deklaruar fajtor edhe për veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë pa rimarrë provat kryesore, pa ripyetur dëshmitarët relevantë dhe pa proceduar me riçelje të shqyrtimit gjyqësor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, mospërmbyshja edhe

vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

9. Në verifikim të plotësimit të këtyre kriterëve, në rastin konkret, në analizën e legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji evidenton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të paanshmërisë, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, parimit të mosdënimit pa ligj, së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, standardit të arsyetimit, si dhe parimin *ne bis in idem*, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin e ligjshmërisë, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim.

10. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të paanshmërisë*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se gjyqtaret M.M. dhe I.O. kanë qenë anëtare të trupit gjykues në seancat gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë dhe njëkohësisht anëtare të trupit gjykues në gjykatën e apelit. Sipas tij, këto gjyqtare kanë shqyrtuar të njëjtat prova dhe fakte dhe kanë rrëzuar disa kërkesa të kërkuesit, si ato për ekspertimin mbi pamjet filmike, qelizat telefonike, marrjen e dëshmitarëve kyç të mbrojtjes.

11. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se respektimi i *parimit të paanshmërisë*, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose të interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar, si dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë. Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo

vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëm i bazuar (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, nga përmbajtja e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, Kolegji konstaton se gjyqtaret kanë qenë pjesë e trupit gjykues të kësaj gjykate dhe më pas janë transferuar në GJKKO-në e Apelit, si pjesë e kolegjit që ka vendosur për themelin e çështjes, pra për fajësinë e kërkuesit. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e dy gjyqtareve, kërkesë e cila i është rrëzuar për shkak se nuk është respektuar prej tij afati 3-ditor i parashikuar nga ligji për paraqitjen e saj. Po kështu, këtë pretendim kërkuesi e ka ngritur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Kjo e fundit ka vlerësuar se vetëm në procesin e marrjes dhe të dhënies së vendimit gjyqtari jep qëndrimin e tij për çështjet e faktit dhe të ligjit që ka marrë në shqyrtim. Vendimet e ndërmjetme nuk përbëjnë shprehje të vlerësimit përfundimtar mbi fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit. Këto janë pjesë e funksionit të zakonshëm të gjyqtarit dhe nuk krijojnë papajtueshmëri ose paragjykim. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit është një gjykatë fakti dhe ligji, por shqyrtimi i saj është i kufizuar nga shkaqet e ankimit të ngritura nga palët dhe kjo do të thotë se nuk rishqyrton automatikisht të gjithë çështjen nga e para, por kontrollon vendimin e shkallës së parë në dritën e pretendimeve të ngritura në apel. Ndërkohë të gjitha pretendimet e kërkuesit të ngritura në ankim kanë marrë përgjigje të arsyetuar në vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, arsyetim ky që nuk është bërë nga gjyqtaret kundrejt të cilave ngrihet pretendimi për papajtueshmëri. Në përfundim Gjykata e Lartë ka vlerësuar se dyshimi për paanësinë e gjyqtareve të apelit nuk është i justifikuar objektivisht.

13. Në analizë të sa më sipër, Kolegji konstaton se gjyqtaret që kanë shqyrtuar çështjen në apel kanë marrë pjesë në disa seanca gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë dhe në dhënien e disa vendimeve të ndërmjetme, por nuk kanë qenë pjesë e vendimmarrjes përfundimtare në gjykimin në shkallë të parë. Për këtë shkak, Kolegji vlerëson se nuk vihet në dyshim paanshmëria e tyre gjatë shqyrtimit të çështjes në apel, pasi nuk rezulton që ato të kenë shprehur më parë vlerësim për fajësinë e kërkuesit, i cili do të mund të vinte në dyshim respektimin e standardit të paanshmërisë në gjykim në aspektin objektiv. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë është haptazi i pabazuar.

14. Lidhur me pretendimin për cenimin e *parimit të mosdënimit pa ligj*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar dy shkaqe: (i) gjykatat kanë rrëzuar kërkesën për gjykim të shkurtuar me arsyetimin se neni 403, pika 2, i KPP-së ndalon gjykimin e shkurtuar për veprat penale që dënohen me burgim të përjetshëm; (ii) kjo dispozitë krijon diskriminim ndaj personave të akuzuar për vepra me burgim të përjetshëm, të cilët privohen nga mundësia e uljes së dënimit prej gjykimit të shkurtuar, pavarësisht pranimit të akuzës.

15. Gjykata ka theksuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*), e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 16, datë 15.06.2009; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me gjykimin e shkurtuar në procesin penal, Gjykata ka pranuar se ai nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit dhe në rast se ai ka dyshime mbi këtë vlerësim, kjo mjafton që të rrëzojë kërkesën e të pandehurit (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore Kolegji vëren se kërkuesi ka paraqitur kërkesë për t'u gjykuar me ritin e gjykimit të shkurtuar, e cila është rrëzuar për shkak se veprat penale për të cilat ai akuzohet parashikojnë dënime me burgim të përjetshëm, çka përbën pengesë për këtë gjykim bazuar në nenin 403, pika 2 të KPP-së. Edhe Gjykata e Lartë i ka kthyer përgjigje këtij pretendimi, duke vlerësuar se të dyja gjykatat kanë arritur në përfundim të drejtë për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe se ndalimi i nenit 403, pika 2, të KPP-së nuk cenon parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit. Sipas saj, trajtimi i ndryshëm i personave të akuzuar për një krim për të cilin parashikohet një dënim i tillë, me personat e akuzuar për vepra penale të tjera është parashikuar për shkak se të parët janë të akuzuar për kryerjen e një krimi që ka një rrezikshmëri të theksuar shoqërore që ligjvënësi në mënyrë abstrakte e konsideron të papajtueshëm me gjykimin e shkurtuar.

17. Në këtë kuptim, për sa i përket shkakut të parë të pretenduar nga kërkuesi, Kolegji evidenton se gjykatat e zakonshme kanë vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe se në refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar nuk rezulton që ato të kenë bërë një arsyetim arbitrar,

në kuptimin e gabimeve faktike ose ligjore, për sa kohë neni 403 i KPP-së ndalon në mënyrë të shprehur aplikimin e gjykimit të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm.

18. Ndërsa në lidhje me shkakun e dytë, se dispozita krijon diskriminim ndaj personave të akuzuar për vepra me burgim të përjetshëm, të cilët privohen nga mundësia e uljes së dënimit prej gjykimit të shkurtuar, pavarësisht pranimi të akuzës, Kolegji vëren se përjashtimi i mundësisë së aplikimit të gjykimit të shkurtuar për të pandehurit e akuzuar për vepra penale për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm përbën një zgjedhje të legjislatorit, i cili gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi në përcaktimin e rasteve dhe të kushteve të zbatimit të instituteve procedurale. Në këtë kuptim, vetëm fakti që një kategori të pandehurish nuk përfiton nga ky institut, nuk mjafton për të arritur në përfundimin se ata trajtohen në mënyrë diskriminuese. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për të mos u dënuar pa ligj, për shkak të mospranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, është haptazi i pabazuar.

19. Në lidhje me cenimin e parimit *ne bis in idem*, kërkuesi ka pretenduar se është dënuar njëkohësisht për veprat penale konkrete dhe për veprën penale “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”. Pra, sipas tij, gjykatat kanë aplikuar në mënyrë kumulative dy dispozita ndaj të njëjtit fakt, bashkëpunimit kriminal.

20. Kolegji vëren se këtë pretendim kërkuesi e ka paraqitur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila ka vlerësuar se kjo çështje është zgjidhur me vendimin njësoj nr. 00-2024-2155 (107), datë 24.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është arritur në përfundimin se neni 334 i KP-së nuk është vepër penale më vete, por dënim që i shtohet dënimit të caktuar për veprën konkrete dhe se zbatimi i këtij neni në raport me nenet 333 dhe 333/a të KP-së nuk cenon parimin e mosgjyqimit dy herë për të njëjtin fakt penal.

21. Në rastin konkret, Kolegji evidenton se kërkuesi është dënuar nga GJKKO-ja e Apelit për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal” në formën e pjesëmarrjes, të parashikuar nga neni 333/a, paragrafi i dytë, i KP-së dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim; “Vrasja me paramendim” për hakmarrje e mbetur në tentativë ndaj viktimës Xh.Sh., të kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga neni 78, paragrafi i dytë, në lidhje me nenet 22 dhe 28, pika 4, të KP-së, si dhe në bazë të nenit 334, pika 1, të KP-së, dënimin e tij me 25 vjet burgim;

“Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” ndaj dy ose më shumë personave, të kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga neni 79/dh, në lidhje me nenin 28, pika 4, si dhe në bazë të nenit 334, pika 2, të KP-së, dënimin e tij me burgim të përjetshëm; “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, në lidhje me nenin 28, pika 4, si dhe në bazë të nenit 334, pika 1, të KP-së dënimin e tij me 10 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55, paragrafi i parë, të KP-së, në bashkim të dënimeve, ka caktuar përfundimisht ndaj kërkuesit një dënim të vetëm, atë me burgim të përjetshëm.

22. Në këtë drejtim, Kolegji thekson se përcaktimi i veprave penale, llojeve dhe masave të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre në raste konkrete është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023, nr. 47, datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*), ndërsa Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Mbledhja e Gjyqtarëve ka mbajtur qëndrimin se kur i pandehuri kryen vepër penale në rrethanën cilësuese të bashkëpunimit në formën e krimit të organizuar, zbatimi i nenit 334 të KP-së nuk cenon parimin *ne bis in idem*. Në këto raste, zbatimi i nenit 334 të KP-së shton masën e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale të kryer për shkak të rrethanës cilësuese të pjesëmarrjes në krim të organizuar. Në këtë kuptim, neni 334 i KP-së nuk zbatohet veçmas dhe nuk është autonom, por ai shoqëron dispozitën penale të veprës konkrete të kryer dhe e cilëson atë si të kryer nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal (*shih vendimin nr. 42, datë 05.04.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

24. Në të njëjtin drejtim, Gjykata e Lartë, në jurisprudencën e saj njësuese për këto dispozita, ka arritur në përfundimet se: i) neni 334, ndonëse është një dispozitë e KP-së, në raport me nenin 28, paragrafët 5 dhe 6, të këtij kodi, nuk është një vepër penale më vete, por dënim që i shtohet dënimit të caktuar nga gjykata për veprën penale konkrete të kryer nga organizatori ose

pjesëmarrësi në një organizatë kriminale ose në një grup të strukturuar kriminal. Veprat penale të parashikuara në nenet 333 dhe 333/a të KP-së janë vepra penale formale, që nënkupton se personi dënohet për kryerjen e këtyre veprave (në formën e krijimit, organizimit, drejtimit ose pjesëmarrjes), pavarësisht nëse kryen ose jo ndonjë vepër penale konkrete; ii) zbatimi i nenit 334 të KP-së në raport me nenet 333 dhe 333/a të këtij kodi nuk cenon parimin e mosgjykimit dy herë për të njëjtin fakt penal (sipas nenit 7 të KPP-së), pasi neni 334 i KP-së përbën dënim të shtuar vetëm kur pjesëtarët e organizatës kriminale ose grupit të strukturuar kriminal kryejnë një vepër penale konkrete. Veprat penale “Organizata Kriminale”/“Grupi i strukturuar kriminal” kryhen në formën e krijimit, organizimit, drejtimit ose pjesëmarrjes dhe cilësohen nga kodi si vepra penale më vete. KP-ja ndëshkon jo vetëm kryerjen e veprave penale konkrete në kuadër të një organizate kriminale ose grupi të strukturuar kriminal, por edhe vetë krijimin, organizimin, drejtimin ose pjesëmarrjen në një organizatë kriminale ose grup të strukturuar kriminal, të parashikuara si vepra penale më vete, sipas neneve 333 dhe 333/a të KP-së; iii) neni 334 i KP-së nuk është një dispozitë që zbatohet veçmas (nuk është vepër penale), por është dënim i shtuar që shoqëron dispozitën penale që parashikon figurën e veprës penale konkrete të kryer nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal (*shih vendimin nr. 00-2024-2155 (107), datë 24.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

25. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se nenet 333/a dhe 334 të KP-së kanë natyrë të ndryshme. Kështu, neni 333/a i KP-së parashikon si vepër penale të mëvetshme pjesëmarrjen në grup të strukturuar kriminal, ndërsa neni 334 i KP-së nuk parashikon një vepër penale autonome, por vepron si dispozitë që cilëson dhe rëndon dënimin për veprën konkrete penale të kryer në kuadër të organizatës kriminale ose të grupit të strukturuar kriminal. Në këtë kuptim, në rastin konkret, gjykatat e zakonshme nuk rezultojnë të kenë trajtuar nenin 334 të KP-së si akuzë të pavarur, por si rrethanë cilësuese të veprës penale konkrete, ndërkohë që kanë vlerësuar më vete përgjegjësinë penale për pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal sipas nenit 333/a të KP-së. Kjo mënyrë e interpretimit dhe zbatimit të dispozitave penale është në përputhje me jurisprudencën njësuere të Gjykatës së Lartë për normat ligjore të zbatueshme, çka përforcon përfundimin se, në rastin konkret, ligji penal ka qenë i parashikueshëm në zbatimin e tij dhe se interpretimi i bërë nga gjykatat e zakonshme nuk rezultojnë të jetë i paparashikueshëm, arbitrar ose në kundërshtim të

dukshëm me përmbajtjen e dispozitave penale të zbatuara. Për rrjedhojë, për sa kohë nenet 333/a dhe 334 të KP-së kanë natyra dhe funksione të ndryshme juridike, nuk rezulton që gjykatat e zakonshme t'i kenë dhënë së njëjtës sjelljeje penale dy pasoja të pavarura në kundërshtim me parimin *ne bis in idem*. Në këto kushte, edhe ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

26. Kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, duke argumentuar se gjykatat kanë refuzuar një sërë provash të paraqitura nga mbrojtja e tij si kërkesat për ekspertimin mbi pamjet filmike dhe fotografike, analizën e të dhënave të qelizave telefonike dhe thirrjen e dëshmitarëve kyç të mbrojtjes dhe ballafaqimin e dy prej tyre.

27. Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë së armëve në procesin penal, si pjesë e procesit të rregullt ligjor, synon të realizojë një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe në dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër dhe secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të prezantuar çështjen e vet, në kushte të cilat nuk e vendosin në një pozitë më pak të favorshme përkundrejt kundërshtarit (*shih vendimet nr. 23, datë 23.07.2009; nr. 19, datë 18.09.2008; nr. 13, datë 21.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e provave në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit kushtetues, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se nuk është detyrë e saj të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove, për sa kohë që gjykatat e zakonshme, në arsyetimin e vendimeve të tyre, e mbështesin fajësinë e kërkuarit edhe mbi disa prova të tjera (*shih vendimet nr. 40, datë 22.09.2011; nr. 42, datë 18.12.2007; nr. 9, datë 28.04.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuari është gjykuar me procedurën e gjykimit të zakonshëm, gjatë të cilit ai ka paraqitur disa kërkesa në lidhje me provat, për të cilat GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se ato janë të pabazuara në nenin 427, pika 1, të KPP-së. Për këtë shkak, ajo gjykatë ka mbajtur qëndrimin se mund të vendosë në gjendjen që janë aktet dhe se nuk

është e nevojshme përsëritja e shqyrtimit gjyqësor dhe marrja e provave. Ky qëndrim i gjykatës është mbështetur edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka konstatuar se kërkimet për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave nëpërmjet ekspertimit për identifikimin e pamjeve filmike të depozituara nga shtetasi F.L., kryerjen e ekspertimit për të përcaktuar logimet e telefonave nisur nga qelizat telefonike dhe rimarrjen e dëshmisë së dëshmitarit S.T. janë vlerësuar të pabazuara nga gjykata e apelit. Gjykata e Lartë, mbështetur në jurisprudencën e saj dhe të Gjykatës, ka vlerësuar se riçelja e shqyrtimit gjyqësor në apel është kompetencë diskrecionale e gjykatës së apelit dhe se përsëritja e shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e apelit vlerësohet prej saj rast pas rasti, në ushtrim të pushtetit të saj si gjykatë ligji dhe fakti. Gjithashtu, ajo ka vlerësuar se pretendimet për çmuarjen e provave, fuqinë e tyre provuese, besueshmërinë e dëshmitarëve, provueshmërinë e faktit penal përkundrejt të gjykuarve janë të karakterit faktual dhe, si të tilla, dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

29. Në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të zakonshme, konstatohet se këto të fundit i kanë krijuar kërkuesit të njëjtën mundësi si akuzës për të paraqitur çështjen, sikundër edhe për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tij. Shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykatat nuk është bërë vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga akuza, por, përkundrazi, kërkuesit i është dhënë mundësia të dëgjohet për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore. Kolegji vëren gjithashtu se gjykata e apelit nuk e ka ndryshuar vendimin duke e deklaruar kërkuesin fajtor mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm të provave. Përkundrazi, edhe ajo ka pranuar të njëjtën situatë faktike, por ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, e cila nuk ka gjetur elemente të veprës penale, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin e kundërt. Kjo vendimmarrje në thelb ka të bëjë me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, rrethanë e cila përjashton detyrimin që gjykata e apelit duhet të përsërisë shqyrtimin gjyqësor për të vlerësuar drejtpërdrejt deklaratimet e dëshmitarëve. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se, për sa kohë marrja e provave në proces i është nënshtruar debatit real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes ndaj edhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

30. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, kërkuesi ka pretenduar se procesi i marrjes së materialeve fotografike/filmike nga shtetasi F.L. paraqet shkelje në disa drejtime; gjykata lejoi

kryerjen e procedurës së njohjes *de facto* nëpërmjet fotografive brenda seancave të marrjes me dëshmi duke shkrirë dy institute juridike të ndryshme, si dhe aktet për zgjatjen e hetimeve paraprake kanë qenë të pavlefshme, pasi ato nuk iu njoftuan të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

31. Neni 32, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtën për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Në frymën e kësaj dispozite, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ndaj në këtë drejtim detyra e saj (Gjykatës) është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë (*shih vendimet nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 57, datë 21.12.2012; nr. 47, datë 07.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Pranimi dhe vlerësimi i provave, si rregull, bëhet nga gjykatat e zakonshme, kurse detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën është marrë prova, ka qenë i rregullt (*shih vendimet nr. 19, datë 02.04.2012; nr. 7, datë 27.04.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Marrja e provave në procesin penal rregullohet nga nenet 149-152 të KPP-së. Midis të tjerave, këto dispozita parashikojnë se provat merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë nëse prova vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit (neni 149 i KPP-së). Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren, ndërsa papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit. Për përjashtimin e provave të ndaluara nga ligji ose ato që janë haptazi të panevojshme vendos gjykata e zakonshme gjatë gjykimit (neni 151 i KPP-së).

33. Kolegji vëren se kërkuesi i ka paraqitur këto pretendime edhe në gjykatat e zakonshme. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nuk ka konstatuar akte procedurale të pavlefshme ose prova të papërdorshme. Për sa u përket vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve, kjo gjykatë ka konstatuar se ato i janë njoftuar mbrojtësve bazuar në nenet 324-325 të KPP-së. Lidhur me kërkesën për deklarimin e pavlefshëm të procesverbalit për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve nga shtetasi F.L. gjykata konstatoi se janë respektuar rregullat e parashikuara nga neni 191 i KPP-

së që kanë të bëjnë me provat dokument. Ndërsa për sa i përket kërimit për papërdorshmërinë e tabulateve telefonike, qelizave gjeografike të personave në momentin e komunikimit, gjykata vlerësoi se marrja dhe administrimi i tyre nuk është formë përgjimi për të cilin duhet të respektohen rregullat e parashikuara nga nenet 221-222 të KPP-së, por prova të llojit dokument dhe për marrjen e tyre janë respektuar rregullat e parashikuara nga neni 191 i KPP-së. Po kështu, për sa u përket veprimeve hetimore të kryera nga oficerët e Policisë Gjyqësore, gjykata çmoi se këta të fundit janë subjekte procedurale që kryejnë çdo veprim të urdhëruar nga prokurori, si dhe kryejnë me iniciativë çdo veprim hetimor të nevojshëm. Sipas gjykatës, vendimet e këqyrjeve, sekuestimeve, ekspertimeve nuk janë absolutisht të pavlefshme.

34. Në vijim, GJKKO-ja e Apelit i ka gjetur këto pretendime të pabazuara, duke e konsideruar të rregullt dhe në përputhje me dispozitat e KPP-së zhvillimin e gjykimit të themelit nga gjykata e shkallës së parë. Lidhur me pretendimet për pavlefshmërinë e akteve të zgjatjes së afatit të hetimeve gjykata e apelit ka vlerësuar se neni 324 i KPP-së nuk parashikon me pasoja pavlefshmërie mosnjoftimin e tyre të pandehurit, dispozitë që e lexuar me nenin 128 të KPP-së e bën të pabazë kërkimin për pavlefshmëri të këtyre akteve, njoftimi i të cilave i është bërë kërkuarit nëpërmjet mbrojtësit të caktuar kryesisht. Për sa i përket kërkesës për deklarimin e pavlefshëm të procesverbalit të këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve të dorëzuara nga shtetasi F.L., që është akti që dokumenton veprimin, hartuar në përputhje me nenin 191 të KPP-së, kjo gjykatë ka vlerësuar se ai nuk parashikon kërkesa të posaçme për formën dhe as pasoja të pavlefshmërisë. Edhe kërkesat për papërdorshmërinë e provave të marra nga kompanitë telefonike, tabulatet, qelizat gjeografike të vendndodhjes, gjykata e apelit, sikurse gjykata e shkallës së parë, i ka konsideruar se nuk janë veprime përgjimi, që marrja e tyre të rregullohet nga nenet 221-222 të KPP-së. Sipas gjykatës së apelit, ato përbëjnë prova të llojit dokument të parashikuara nga neni 191 i KPP-së, i cili nuk parashikon ndalime për marrjen, duke lejuar marrjen e çdo dokumenti që përfaqëson fakte, persona ose sende nëpërmjet fotografimit, filmimit ose çdo mjeti tjetër.

35. Po kështu, këto pretendime kërkuari i ka paraqitur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila ka mbajtur të njëjtin qëndrim me gjykatat e zakonshme. Sipas asaj gjykate, pretendimet për papërdorshmërinë e provave, të cilat kualifikohen në rekurs sipas llojit të provës së pretenduar prej mbrojtjes dhe jo sipas mënyrës sesi janë administruar, nuk mbështeten në

dispozitat ligjore të KPP-së dhe, për këtë arsye, nuk cenojnë vendimarrjen e gjykatave. Gjykata e Lartë ka theksuar gjithashtu se jo vetëm gjykata e apelit, por edhe gjyqtari i seancës paraprake dhe gjykata e shkallës së parë u kanë dhënë përgjigje të mirargumentuara këtyre pretendimeve. Sipas saj, çdo pretendim i mbrojtjes ka marrë përgjigje nga gjykatat e faktit dhe nuk konstatohet asnjë shkelje ose cenim i të drejtave kushtetuese dhe garancive procedurale, por as papërdorshmëri e provave në interpretim të nenit 153, pika 4, të KPP-së.

36. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se procesi gjyqësor i zhvilluar në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, nuk rezulton të ketë qenë i padrejtë dhe vendimi i fajësisë nuk është mbështetur në prova të marra në kundërshtim me parashikimet ligjore. Në të gjitha shkallët e gjykimit, kërkuesit, nëpërmjet mbrojtësit të tij, i është dhënë mundësia për t'u njohur dhe për të debatuar mbi të gjitha provat e paraqitura nga akuza, si dhe për të paraqitur argumentet dhe provat e tij për çështjen. Po kështu, ai ka ngritur pretendime për mënyrën e marrjes së provave dhe vlefshmërinë e akteve procedurale përpara gjykatave të zakonshme, çka nënkupton se i është dhënë mundësia për të kundërshtuar autenticitetin dhe ligjshmërinë e tyre. Këto pretendime janë marrë në shqyrtim dhe atyre u është dhënë përgjigje me vendim të arsyetuar, i cili nuk rezulton i padrejtë në aspektin kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme është haptazi i pabazuar.

37. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të ligjshmërisë*, për shkak se GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për sa i përket fajësisë së kërkuesit, duke e deklaruar fajtor edhe për veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë; *parimin e prezumimit të pafajësisë*, pasi fajësia e kërkuesit është përcaktuar me prova indirekte, pa lidhje të drejtpërdrejtë me vendin e ngjarjes, pa dëgjuar drejtpërdrejt provat, duke cenuar standardin tej çdo dyshimi të arsyeshëm, si dhe *standardin e arsyetimit të vendimit*, pasi gjykatat nuk dhanë asnjë shpjegim se përse deklarimet fillestare të dëshmitarëve okularë u anashkaluan ose përse u pranuan deklarimet e dyta. Nisur nga thelbi i këtyre pretendimeve, Kolegji çmon t'i analizojë ato në drejtim të parimit të *prezumimit të pafajësisë* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit*.

38. Parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së

prerë. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ky parim kërkon që gjykatat e zakonshme të mos e fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Asnjë dënim ose masë që barazohet me të nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 12, datë 24.08.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Gjykata ka theksuar gjithashtu se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 70, datë 15.10.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 1, datë 20.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe, për këtë arsye, vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë

ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka deklaruar kërkuesin fajtor për veprat penale të vrasjes në rrethana cilësuese dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake të kryera në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal duke u bazuar në një sërë aktesh e provash të analizuara, siç janë procesverbalet e këqyrjes së vendit të ngjarjes, aktet e ekspertimit mjeko-ligjor, të dhënat nga kompanitë celulare dhe të komunikimit telefonik, analiza e logimeve të numrave të telefonit në vendin e ngjarjes ku është kryer vepra penale, në vendin ku autorët kanë djegur mjetin me të cilin kanë lëvizur, si dhe në vendin ku janë vjedhur makina dhe targat e mjetit që autorët kanë përdorur për të realizuar krimin, këqyrja e të dhënave nga sistemi TIMS, provat me dëshmitarë, deklaratimet e shtetasve të pyetur me cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale, si dhe të gjitha provat e tjera të shqyrtuara gjatë gjykimit, të cilat në tërësinë e tyre provojnë, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, kryerjen e këtyre veprave penale nga të pandehurit. Konkretisht, dëshmitarët okularë kanë deklaruar se kanë njohur kërkuesin në momentin kur ai është afruar me vendin e ngjarjes, deklaratime që përputhen me pamjet filmike. Po kështu, sipas gjykatës, nga analiza e tabulateve telefonike rezulton se telefoni i regjistruar në emër të babait të kërkuesit ka loguar në vendin e ngjarjes dhe në vendin ku është djegur mjeti me të cilin ai ka udhëtuar. Sipas saj, alibia e kërkuesit nuk qëndron pasi nuk përputhet me aktet dhe me provat e analizuara gjatë gjykimit dhe bëhet vetëm me qëllim për të lehtësuar pozitën e tij dhe shmangur përgjegjësinë penale. Sipas gjykatës kërkuesi ka bashkëpunuar me dy të pandehurit e tjerë, me qëllim vrasjen për hakmarrje të shtetasit Xh.Sh., me të cilin njëri prej të pandehurve ka pasur konflikte të hershme. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se akuza për veprën penale të vrasjes me paramendim, të kryer për hakmarrje, të mbetur në tentativë, ndaj shtetasit Xh.Sh. duhet të pushohet, pasi ekziston pamundësia absolute e cenimit të objektit, pra jetës së këtij shtetasi, e cila nuk është cenuar, pasi ai nuk ndodhej në vendin e ngjarjes. Në përfundim, kjo gjykatë ka caktuar dënimin me burgim të përjetshëm për kërkuesin.

42. GJKKO-ja e Apelit e ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë për sa i përket fajësisë së kërkuesit, e cila, sipas saj, provohet nga deklaratimet e dëshmitarëve, regjistrimet filmike, qelizat telefonike. Megjithatë, kjo gjykatë, në ndryshim nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë,

e ka vlerësuar të pabazuar pushimin e akuzës për veprën penale të vrasjes me paramendim për hakmarrje të mbetur në tentativë ndaj shtetasit Xh.Sh. Sipas GJKKO-së së Apelit, objektivi kryesor i planit kriminal ishte pikërisht vrasja e këtij shtetasi, por edhe sulmi i çdo personi që bënte pjesë në shoqërinë e tij të ngushtë dhe pranë tij, kjo e provuar nga deklaratat e dëshmitarëve dhe nga analiza tërësore e provave. Në vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë ka kontradiktë në arsyetim për sa kohë, nga njëra anë, pranon se i pandehuri L.H. ka tentuar të vrasë shtetasin Xh.Sh., duke krijuar grupin e strukturuar kriminal ku bën pjesë kërkuesi dhe, nga ana tjetër, është konkluduar se vepra penale nuk është konsumuar dhe nuk ka mbetur në tentativë. Kështu, sipas gjykatës së apelit, kërkuesi dhe të pandehurit e tjerë, duke ndërmarrë me paramendim veprimin konkret për kryerjen e veprës penale të vrasjes për të marrë hak ndaj viktimës Xh.Sh., vepër e cila nuk është përfunduar për rrethana të pavarura prej tyre, duke mos ardhur pasoja e dëshiruar prej autorëve, marrja e jetës së tij, ndodhen në situatën e ndëshkimit penal të tyre për tentativën. Po sipas gjykatës, qëndron jashtë aspektit të përgjegjësisë penale se cili konkretisht nga anëtarët e grupit mbante armë luftarake, edhe pse faktet provojnë në mënyrë të padyshimtë se ishin armatosur që të tre të pandehurit. Për sa i përket kërkuesit, gjykata ka vlerësuar se edhe pse nuk ka qenë ekzekutor i drejtpërdrejtë i vrasjeve të kryera ose të mbetura në tentativë, është pjesëmarrës me vetëdije të plotë në realizimin e ngjarjeve kriminale dhe është përgjegjës për të gjitha veprat penale të kryera nga grupi i strukturuar kriminal. Në përfundim, ajo ka lënë në fuqi dënimin me burgim të përjetshëm për kërkuesin.

43. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se pretendimet për çmuarjen e provave, fuqinë e tyre provuese, besueshmërinë e dëshmitarëve, provueshmërinë e faktit penal përkundrejt të gjykuarve janë të karakterit faktual dhe si të tilla dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të kësaj gjykate. Po kështu, pretendimet e paraqitura në rekurs kanë marrë përgjigje të argumentuara nga gjykata e apelit. Edhe për sa i përket pretendimit për zbatimin e gabuar të ligjit material, Kolegji Penal ndan të njëjtin qëndrim me gjykatën e apelit, për cilësimin juridik të faktit penal, ekzistencën e bashkëpunimit të posaçëm në formën e grupit të strukturuar kriminal, si dhe ekzistencën e tentativës së papërfunduar në vrasjen me paramendim ndaj viktimës Xh.Sh. Sipas Kolegjit Penal, nuk ndodhemi përpara një krimi të pamundur, por përpara një vepre penale të mbetur në tentativë, pasi mjetet, mënyra dhe veprimet

e ndërmarra nga autorët kanë qenë objektivisht të përshtatshme dhe të afta për të sjellë pasojën e synuar, pra humbjen e jetës së viktimës Xh.Sh. Po kështu, Kolegji Penal ka vlerësuar se në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material, GJKKO-ja e Apelit ka konkluduar se kërkuesi ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet dhe se tërësia e provave dhe indicieve janë analizuar në unitet me njëra-tjetrën dhe, në vlerësimin tërësor të tyre, janë çmuar në përputhje me kërkesat e ligjit procedural penal. Gjithashtu, nuk është bërë vetëm citimi i provave të verifikuara në procesin penal, por analizë cilësore. Në konkluzion, Kolegji Penal ka vlerësuar se, me të drejtë, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se kërkuesi ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

44. Në analizë të përmbajtjes së vendimeve të mësipërme, Kolegji çmon se gjykatat e kanë deklaruar fajtor kërkuesin, duke shqyrtuar dhe vlerësuar një tërësi provash, si deklaramet e dëshmitarëve, të dhënat e vendndodhjes së qelizave telefonike dhe pamjet filmike, të cilat janë analizuar në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën, ndaj nuk rezulton që ato të kenë arritur në një konkluzion *a priori* për fajësinë e tij. Vendimet e gjykatave më të ulëta janë mbështetur vetëm në faktet e paraqitura gjatë procesit gjyqësor dhe përmbajnë bazën ligjore, analizën e provave, mënyrën e zgjidhjes së çështjes, konkretisht deklarametin e kërkuesit fajtor për veprat penale, për të cilat është akuzuar. Ato gjykata nuk e kanë nisur procesin gjyqësor me bindjen se kërkuesi ka qenë fajtor dhe as e kanë zhvendosur barrën e provës nga prokurori te ai. Ndonëse gjykata e apelit ka deklaruar kërkuesin fajtor edhe për një tjetër vepër penale për të cilën është vendosur pushimi i gjykit nga gjykata e shkallës së parë, konstatohet se ankim kundër vendimit të kësaj të fundit ka ushtruar edhe prokurori. Po kështu, interpretimi i dispozitave penale në këtë rast, i mbështetur edhe nga qëndrimi i Gjykatës së Lartë, rezulton të respektojë parimin e ligjshmërisë dhe nuk është arbitrar.

45. Po kështu edhe Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs nga kërkuesi. Ajo ka marrë në shqyrtim pretendimin në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe në ushtrim të rolit të saj si gjykatë ligji, ajo ka verifikuar këto pretendime, duke arritur në përfundimin se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejt ligjin material dhe procedural. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë plotëson të gjitha elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij. Gjithashtu, nuk konstatohet që interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë të ketë qenë arbitrar në nivelin që të mund të konsiderohet se kërkuesit i

janë cenuar të drejtat kushtetuese të pretenduara. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit duket të jenë haptazi të pabazuara.

46. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.